



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

**VENDIM**

**Nr. 53, datë 06.07.2018**

**PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME HAS**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a Ujësjetllës Kanalizime Has për licencim për efekt përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Has me NUIS J66702907H është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 24 datë 02.11.2009 "Për rinovim licence Ujësjetllës Kanalizime Has" me vlefshmëri 4 vjeçare deri në datë 02.11.2013;
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Has me anë të shkresës nr. 68 prot. të datës 12.06.2018, ka aplikuar pranë ERRU për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës dhe shtimit të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura.
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Has plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:
  - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
  - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar i plotë;

- Në lidhje me Drejtuesin Teknik, shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Has duhet që brenda dy viteve nga marrja e licencës të sigurojë drejtues teknik që i plotëson kriteret e parashikuara në VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

**VENDOSI:**

1. Licencimin e operatorit sh.a Ujësjetllës Kanalizime Has me:

Drejtues Ligjor Z. Xhemil Thaçi

Drejtues Teknik Z. Hajredin Cahani

2. Operatori sh.a Ujësjetllës Kanalizime Has autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Has:

Njësia administrative: Krumë

Gjinaj

Fajza

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Ndriçim SHANI**